



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Nr. \_\_\_\_ prot

Data 10.05.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **BLERJE USHQIMESH PER QENDREN E LIRA BERAT**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15800000-6  
Produkte ushqimore te ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 696 455.9 ( tre milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë presje nente) lek pa TVSH.,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. **Xhiroja vjetore minimale** -Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera



~~e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.~~

REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar;*

Si dhe në nenin 43 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe nenin 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se *4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.*

Vendosja e këtyre kritereve bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nëpërmjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të*

*deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimimi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave,

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimimi tre vitet e fundit financiare,



~~që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021, nenin 43, pika 4 (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.~~

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilancave është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, igjit nr.25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. **Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme** në një vlerë jo më të vogël **20%** të vlerës së fondit limit, për të cilin konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë :

- a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e më parshme kërkon vërtetime të ëshuara nga një entepublik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat ,sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” , në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se

*operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti*



~~kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]~~  
*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat ethjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se **20%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me e vogel se **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij **licencën II.1.A.1 ”Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**. Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga QKB me kete licence, duhet të paraqesin ekstraktin tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.3. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të jenë te pajisur me

\* certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to.

\* certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe**



~~specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të cilesise ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.~~

2.3.5. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesin certifikate pronësie të objektit ku ushtrohet aktiviteti ose kontrate qiraje noteriale, të shoqëruar me kopje të lejes higjeno sanitare lëshuar nga Inspektoriat Sanitar (DSHP), si dhe certifikate dezinfektimi të ambientit, foto të ambjentëve të ushtrimit të aktivitetit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar të Ushqimit

2.3.6. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar të Ushqimit

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe**

**specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar të Ushqimit

2.3.8. Në rast se operatori ekonomik është prodhues i produkteve bukë vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij mish dhe nënprodukte të tij, duhet të paraqesë leje higjeno sanitare, license QKL



—me kodin II.1.A.(1), si dhe certifikaten e dezinfektimit 3D per secilen kategori produkti —Raport analizen e ujit te rrjetit per furrin e bukes si dhe lejen mjedisore mjedisore me kodin III.1.B (per trajtimin dhe perpunimin e qumeshtit.

Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i produkteve bukë vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij mish dhe nënprodukte të tij, duhet të paraqesë kontratë furnizimi për këto produkte.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

2.3.9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit të ushqimeve si buke dhe fruta perime . Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor. Ne rastin e disponimit te mjetit me qera duhet te paraqse kontraten e qerase

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij si dhe mishit dhe nënprodukteve të tij . Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Ne rastin e disponimit te mjetit me qera duhet te paraqse kontraten e qerase

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5 germa ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jane hartuar nga specialisti i fushes dhe fondi limit eshte hartuar nga Qendra Lira Berat per nevojat e se ciles po kryhet ky prokurim.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë*



~~cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/l dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.~~

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Shenim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “ Cilesia e pare”, ky percaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Specialist i fushes  
Reita Çela**

**Jurist  
Fjoralda Arapi**

**Specialiste (Ekon)  
Ardisa Zhuka**

**MIRATOHET  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ALMA KULE**